

Objekti i Procedures: : “Mirëmbajtja e Tunelit të Krrabës (Kontrate e re)”

Lidhur me piken 2.3.2 argumentojmë se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Duke qenë se në objektivat e kontraktorit përfshihet ndër të tjera :

- Furnizimin dhe vendosjen e çdo makinerie shtesë/zëvendësuese që mund të nevojitet për ecurinë e shërbimeve në tunel;
- vendosja e pajisjeve, impianteve, sistemeve dhe pjesëve konsumuese;
- mirëmbajtja dhe pajisja me sinjalistikën e duhur të tunelit;
- mirëmbajtja dhe kryerja e shërbimeve për linjën 20 Kv, Fiderat 10 dhe 11 të linjës (dhe 74 shtyllat elektrike, që furnizojnë tunelin nga nënstacioni i Kusarshit).

.....

Menaxheri i Tunelit do të propozojë, kryejë dhe regjistrojë një program të rregullt - 4 - mbi punimet e mirëmbajtjes dhe punimet për zëvendësimin e pjesëve të konsumueshme së bashku me provat dhe testimet e pajisjeve, sistemit SCADA si dhe pajisjeve të tjera operuese/monitoruese në Qendrën e Kontrollit me qëllim garantimin e funksionimit të përhershëm.

si dhe referuar faktit që në Tunelin e Krrabës janë të vendosura:

- sistemi elektrik me pjesë përbërëse:

- tensioni i mesëm (transformatorët, ndërprerësit, shpërndarësit, panelet, kabllot dhe linjat,
-)
- Tensioni i ulët (panelet, pjesët e paneleve)
- Ups (pjesët e ups, bateritë)
- gjeneratorët
- panelet elektrike të qendrës së kontrollit

- sistemi ndriçues me pjesë përbërëse:

- aparaturat e matjes së ndriçimit brenda dhe jashtë tunelit (luminansmetre)
- llambat ndriçuese brenda dhe jashtë tunelit

- sistemit i ventilimit me pjesë përbërëse:

- aparatet që masin rrezen e shikimit në tunel
- aparatet që masin dioksidin e karbonit(co) në tunel
- aparatet që masin shpejtësinë e erës në tunel
- ventilatorët
- kondicionerët në dhomat elektrike

- sistemi i kamerave me pjesë përbërëse:

- kamerat brenda dhe jashtë tunelit
- aparatet digjitale të regjistrimit

- ekrane të kamerave (monitorët)
- aparaturat e vëzhgimit të ngjarjeve

- sistemi i komunikimit me pjesë përbërëse:

- telefonat SOS në tunel
- sistemi i radios në tunel

- sistemi kundër zjarrit me pjesë përbërëse:

- alarmet e tymit
- alarmet e nxehtësisë
- alarmet e zjarrit
- fikset e zjarrit
- hidrantët, pompat, depozitat, tubat e ujit

- sistemi të trafikut me pjesë përbërëse:

- tabelat e limitit të shpejtësisë (vts)
- tabelat e informimit të rrugës (vms)
- radaret
- llambat e trafikut, etj

- qendra e kontrollit me pjesë përbërëse:

- kompjuterët server
- kompjuterët scada
- paneli i njoftimit të zjarreve
- video regjistrim digjital
- video monitorët
- centrali dhe pajisjet e sistemit plc
- centrali telefonik
- centrali i kodimit të kamerave
- regjistruarit të incidenteve

nevojitet që kontraktori të disponojë licencë profesionale për ekzekutimin e sa më sipër konkretisht në kategoritë NP/11A, NS-5/A, NS-12/A, NS-13/A, NS-14/A, kategori këto të cilat i përkasin punimeve/shërbimeve që do të kryejë kontraktori gjatë realizimit të kontratës lidur me sistemet e sipërcituara.

Lidhur me piken 2.3.3 argumentojmë se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Duke qenë se në objektivat e kontraktit përfshihet ndër të tjera :

Menaxheri i Tunelit, sikurse shpjegohet edhe më lart, **do të sigurojë shërbimet e kërkuara të menaxhimit/operimit të tunelit dhe shërbimet e kërkuara të mirëmbajtjes dhe funksionimit të pajisjeve të tij në bashkëpunim me ARRSH-në, Strukturat e Policisë, **Brigadën e Shërbimit të Zjarriksave të Tunelit, si dhe gjithë autoritetet e tjera të përfshira për këtë qëllim;****

Menaxheri i Tunelit do të koordinojë aktivitetet e tij me ato të shërbimit zjarrfikës lokal si dhe duke mbajtur kontakte me shërbimet e policisë së zonës, në mënyrë që dhe këto dy shërbime të tjera të veprojnë së bashku me Menaxherin e Tunelit si një njësi e bashkuar e cila do të jetë efektive në ndalimin e çdo mjeti mbi normat e lejuara, ose të pasigurtë në tunel, kontrollin e sigurtë të fluksit të trafikut dhe të përgatitur ndaj çdo situatë emergjente;

Menaxheri i Tunelit (në përputhje me specifikimet e Artikullit 4, Klauzola 6 e Direktivës së BE), **do të përgatisë, organizojë dhe simulojë periodikisht situata emergjence me qëllim angazhimit dhe trajnimit të shërbimeve të emergjencës** në situata reale që mund të ndodhin në tunel, si dhe dhënien e efekteve reale. Këto ushtrime do të ndërmerren në koherencë me të gjitha autoritetet e tjera të përfshirë në këtë proces;

i dhe duke marrë në konsideratë që **sistemi kundër zjarrit është pjesë përbërëse e tunelit**

nevojitet që kontraktori të disponojë licencë nga QKB për dhënien e asistencë teknike dhe trajnimit të punonjësve për masat PMNZSH.

➤ **Lidhur me piken 2.3.4 argumentojmë se:**

Standardi **ISO 9001** është kthyer në një referencë ndërkombëtare për kërkesat e menaxhimit të cilësisë. Ai lidhet me “menaxhimin e cilësisë”. Kjo do të thotë se, një kompani që e zbaton atë garanton se plotëson:

- cilësinë e kërkuar nga klienti, dhe
- kërkesat e zbatueshme rregullatore

Ndërkohë që synon të:

- rrisë nivelin e shërbimit të ofruar;
- arrijë përmirësim të vazhduar të performancës së saj

ISO 9001 është një “standard gjenerik i sistemit të menaxhimit”. “Gjenerik” (i përgjithshëm) do të thotë se i njëjti standard mund të zbatohet:

- ndaj çdo organizate, e madhe apo e vogël qoftë, ndaj çfarëdo lloji produkti të saj,
- përfshirë edhe rastin nëse “produkti” i saj mund të jetë një shërbim,
- në çdo sektor të aktivitetit, dhe
- nëse është një kompani biznesi, administratë publike, apo një departament qeveritar.

Dukeqenë se kontraktorit do t’i jepet në dorëzim i gjithë dokumentacioni i plotë me të gjitha të dhënat për Sistemet e Mirëmbajtjes dhe funksionimit të Tunelit (*manualet e operimit, raportet, protokollet e mirëmbajtjes, inventarët e magazinave, menaxhimin e rreziqeve dhe sistemet e emergjencës që kërkohen për vazhdimësinë e operimit të tunelit*) të cilat do merren nga Menaxheri i mëparshëm i operimit të Tunelit, si dhe referuar faktit se ky objekt është i klasifikuar si objekt me rëndësi ekonomike dhe strategjike (VKM Nr.1186/2020) nevojitet që kontraktori të disponojë certifikatë **ISO/ 27001:2013**.

Standardi **ISO/ 27001** është një nga standartet më të njohura ndërkombëtare për sigurinë e informacionit.

Siguria e informacionit përcaktohet duke përdorur 3 elemente:

- *konfidencialiteti (informacioni është i disponueshem vetëm për personat e autorizuar);*
- *integriteti (informacioni është i plotë dhe i saktë);*
- *disponueshmeria (personat e autorizuar mund t'i qasen informatave kur ata kanë nevojë);*

Elementi kryesor i ISO 27001 është vlerësimi i rreziqeve të sigurisë që kompania duhet të ndërmarrë dhe vendosja e masave për adresimin e këtyre rreziqeve.

Standardi **ISO/39001**: është një nga standardet më të njohura ndërkombëtare për sigurinë rrugore.

Duke referuar faktit se përgjatë tunelit qarkullon një fluks prej 4-5 milionë automjete në vit, gjatë të cilit ndalojnë më tepër se 3000 mjete brenda në tunel, ku gjithashtu tentativat e këmbësorëve dhe çiklistëve për të kaluar përgjatë tunelit janë të konsiderueshme nevojitet certifikimi me ISO/39001.

Ky standard ka si qëllim zvogëlimin dhe parandalimin e fatalitetëve dhe lëndimeve, si dhe uljen e tyre. Megjithatë ka faktorë të ndryshëm që shkaktojnë aksidente rrugore, ndihma standarde parandalon dëmtimin e shmangshëm duke përdorur ndërhyrje sistematike dhe të bazuara në kuadrin ligjor në fuqi.

Standardi **ISO 45001** i Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë do të sigurojë një përfitim të rëndësishëm në parandalimin e aksidentëve në punë dhe sëmundjeve profesionale;

Standardi ISO 45001 ofron një kornizë me qëllim për të zvogëluar rreziqet në vendin e punës, për të rritur sigurinë e punonjësve dhe për të krijuar kushte më të besueshme të punës dhe përfshin kërkesa për të zvogëluar barrën ndaj tyre;

Duke parandaluar aksidentet e punës dhe sëmundjet profesionale, humbjet që derivojnë për shkak të këtyre rreziqeve janë parandaluar. Kjo situatë është shumë e rëndësishme në drejtim të parandalimit të humbjes së punës, kohës dhe dëmeve materiale nga njëra anë dhe rritjes së motivimit të punonjësve duke ofruar më tepër kualitet nga ana tjetër.

➤ **Lidhur me piken 2.3.5 argumentojmë se:**

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Duke qenë se një ndër sistemet e implementuara në tunel është edhe **sistemi i Radios (Central te sistemit Radio (Transmetues, Marrës, Përsëritës))**, nevojitet edhe certifikimi nga AKEP për "**Rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike**"

➤ **Lidhur me piken 2.3.6 argumentojmë se:**

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të

- përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

Në zbatim të sa më sipër, duke iu referuar objektit të prokurimit, llojit dhe specifikave të shërbimit që do të ofrohet në këtë objekt të klasifikuar si objekt me rëndësi ekonomike dhe strategjike nevojitet një staf prej jo më pak se 60 punonjës.

➤ **Lidhur me piken 2.3.7/ argumentojmë se:**

Kjo kërkesë vjen në zbatim të VKM-së Nr.692 datë 13.12.2001 e ndryshuar

➤ **Lidhur me piken 2.3.8/ argumentojmë se:**

- Kërkesa për **"1 Drejtues teknik përgjegjës për menaxhimin e tunelit duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri transporti ose infrastrukturë të transportit dhe të paktën 10 vjet eksperiencë në administrimin e trafiku"** është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 648 datë 22.07.2015 *"Për Miratimin e kritereve të caktimit të Menaxherit , Oficerit të sigurisë e inspektorit të autorizuar dhe të metodologjisë së analizës së riskut për sigurinë e tuneleve rrugore"* (si dhe në përputhje me termat e referencës të miratuar në zbatim të tij)

- Kërkesa për **"1 Menaxheri Primar të Operimeve Tunel/Oficer Sigurie"** është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 648 datë 22.07.2015 *"Për Miratimin e kritereve të caktimit të Menaxherit, Oficerit të sigurisë e inspektorit të autorizuar dhe të metodologjisë së analizës së riskut për sigurinë e tuneleve rrugore"* (si dhe në përputhje me termat e referencës të miratuara në zbatim të tij).

- Kërkesa për **"3 Operatorët Primarë të Tunelit"** është vendosur në përputhje me termat e referencës si dhe nevojës për këto operatorë për realizimin e kontratës duke analizuar nevojat dhe realizimin e shërbimeve gjatë operimit të tunelit ndër vite.

- Kërkesa për **"1 Përgjegjës të Mirëmbajtjes së pajisjeve.."** është vendosur në përputhje me termat e referencës si dhe nevojës për të për realizimin e kontratës duke analizuar nevojat dhe realizimin e shërbimeve gjatë operimit të tunelit ndër vite.

Sikurse është detajuar më sipër sistemet e implemetuara në tunel së bashku me pajisjet përkatëse janë të llojeve elektrike, elektronike dhe mekanike .

- ✚ Përsa i përket eksperiencës së tyre është kërkuar një periudhë 5 vjeçare në analogji kjo edhe me frymën e VKM-së Nr 648 datë 22.07.2015, si dhe duke marrë në konsideratë rëndësinë strategjike dhe ekonomike të këtij objekti, njëkohësisht edhe shkallën e teknikalitetit të tij.

Gjithashtu duke qenë se shërbimi objekt kontrate i ofruar nga stafi kryesor i tunelit luaj një rol thellësisht teknik dhe ekzistencial për mbarëvajtjen e kontratë vlerësohet e nevojshme që ky staf të rezultojë i punësuar pranë kontraktorit të paktën 3-vitet e fundit, duke garantuar kështu profesionalizëm, stabilitet dhe efikasitet të kontraktorit.

- Kërkesa për stafin ndihmes vendosur në përputhje me termat e referencës si dhe nevojës për to për realizimin e kontratës duke analizuar nevojat dhe realizimin e shërbimeve gjatë operimit të tunelit ndër vite.

Lidhur me kërkesën për:

**Kandidati/ofertuesi duhet të dëshmojë se Menaxher Primar Drejtues për operimet në tunel/Oficer Sigurie dhe të paktën një nga Operatorët Primar të tunelit të jenë të pajisur me certifikatë si 'Ekspert privat zjarrfikës', të lëshuar nga Drejtoria e PMNZH (Ministria e Brendshme)*

➤ argumentojmë se dukeqenë se së termat e referencës kërkohet sa më poshtë vijon :

- Menaxheri i Tunelit (në përputhje me specifikimet e Artikullit 4, Klauzola 6 e Direktivës së BE), do të përgatisë, organizojë dhe simulojë periodikisht situata emergjence me qëllim angazhimin dhe trajnimin e shërbimeve të emergjencës në situata reale që mund të ndodhin në tunel, si dhe dhënjën e efekteve reale. Këto ushtrime do të ndërmerren në koherencë me të gjitha autoritetet e tjera të përfshirë në këtë proces;

- Menaxheri Primar i Operimeve në Tunel duhet që të përgatitë Planin e Menaxhimit të Aksidenteve, i cili përcakton rolet, përgjegjësitë dhe veprimet që duhen ndërmarrë nga Menaxheri i Tunelit, Menaxherit të Operimeve dhe shërbimeve të emergjencës;

Menaxheri Primar i Operimeve në Tunel si Oficer Sigurie duhet:

♣ Të sigurojë koordinim me shërbimet e emergjencës, të simulojë përgatitjen e skemave të operimit për raste emergjente (zjarr në tunel, aksident i rëndë etj);

♣ Të marrë pjesë në planifikim, zbatim dhe vlerësimin e operimeve (ndërhyrjeve) të emergjencës; Të marrë pjesë në përkufizimin e skemave të sigurisë dhe të sigurojë që në përputhje me Artikullin 4, Klauzola 6 e Direktivës së BE, janë kryer gjithë detyrat e mëposhtme:

a) Testimi dhe inspektimi në mënyrë të rregullt i tunelit dhe përgatitja e kërkesave të sigurisë;

b) Vendosja dhe përcaktimi i gjithë skemave organizative dhe operuese (duke përfshirë planet e kundërpërgjigjes në rastet e emergjencës), për trajnimin dhe pajisjen e shërbimeve të emergjencës;

c) Konturimi i plotë i procedurës për mbylljen e menjëhershme të tunelit në rast emergjence;

d) Zbatueshmëria e gjithë masave që duhen marrë për uljen e rrezikut

3. Operatorët Primarë të Tunelit duhet :

♣ Të marrin përsipër përgjegjësitë për kontrollin e vazhdueshëm për sigurimin e cilësisë në të gjitha aspektet e operimit të tunelit, duke përfshirë veprimtaritë që kryen Policia e Shtetit dhe shërbimi zjarrfikës i tunelit, gjatë gjithë kohës së turneve të tyre të punës;

Nevojitet që Menaxher Primar Drejtues për operimet në tunel/Oficer Sigurie dhe të paktën një nga Operatorët Primar të tunelit të jenë të pajisur me certifikatë si 'Ekspert privat zjarrfikës' pasi ata në kuadër të analizimit të situatave do të përgatisin plane masash/projekte ndër të tjera edhe për mbrojtjen nga zjarri të tunelit apo paisjeve të tij.

Proceset e punes qe jane te percaktuara ne Termat e References me Kapituj per realizimin e ketij objekti kerkojne mjetet dhe pajisjet e listuara sipas pikes **2.3.9** te DST.